



**MEMORANDUM BASHKËPUNIMI  
PËR**

**BASHKËRENDIMIN E PUNËS PËR NGRITJEN E STRUKTURËS ADMINISTRATIVE  
PËR DIASPORËN DHE MIGRACIONIN NË QEVERISJEN VENDORE**

**NDËRMJET**

**MINISTRISË SË BRENDSHME**

**MINISTRISË PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME**

**MINISTRIT TË SHTETIT PËR DIASPORËN,**

**DHE**

**SHOQATËS PËR AUTONOMINË VENDORE**



## **PREAMBUL**

Ministria e Brendshme, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministri i Shtetit për Diasporën, Shoqata e Bashkive të Shqipërisë dhe Shoqata për Autonomi Vendore të cilët në vijim të këtij dokumenti do të quhen *Palë*:

*Duke vlerësuar* rëndësinë që ka bashkëpunimi me komunitetet shqiptare në diasporë në ndërtimin e urave lidhëse me vendlindjen, ndërgjegjësimin për shkëmbimin dhe ruajtjen e vlerave kombëtare;

*Për të nxitur* influencën që ka diaspora në zhvillimin ekonomik, politik e kulturor të vendit të origjinës;

*Me dëshirën* për të organizuar politikat e bashkëpunimit e të ndërveprimit me të gjithë shqiptarët, në shtetet pritëse ku ata banojnë,

*Duke synuar* krijimin e strukturave administrative për diasporën dhe migracionin në qeverisjen vendore me qëllim ofrimin e një shërbimi sa më cilësor në çdo njësi vendore,

*Me qëllimin* për forcimin e marrëdhënieve me anëtarët e komuniteteve në diasporë të cilët kanë vendlindjen ose origjinën në territorin të cilin mbulon secila njësi e qeverisjes vendore;

*Duke afirmuar vullnetin* dhe vendosmërinë për të bashkëpunuar dhe kontribuar në realizimin e këtij memorandumi për të përmbushur angazhimet në kuadër të Ligjit Nr. 38/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;

Palët kanë rënë dakord të lidhin këtë Memorandum Bashkëpunimi, në vijim i quajtur Memorandumi.

### **Neni 1 Qëllimi**

1. Qëllimi i këtij memorandumi është angazhimi në krijimin e strukturës administrative pranë bashkive, për diasporën dhe migracionin sipas parashikimeve të nenit 29/1 të ligjit Nr. 38/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.
2. Organizimi i strukturës administrative për diasporën dhe migracionin në njësitë e qeverisjes vendore do të kryhet sipas vlerësimit të numrit të banorëve të tyre. Struktura administrative për diasporën dhe migracionin në bashkitë e vendit do të jetë në nivelin e:
  - Drejtorisë - për bashkitë mbi 50.000 banorë
  - Sektorit - për bashkitë nga 20.000 deri në 50.000 banorë
  - Zyrës - për bashkitë deri në 20.000 banorë
3. Numri i punonjësve të këtyre strukturave do të përcaktohet me vendim të Këshillit Bashkiak. Kriteret profesionale të punonjësve të cilët do të punojnë në strukturën



administrative për diasporën dhe migracionin në njësitë e qeverisjes vendore do të përcaktohen nga Departamenti i Administratës Publike.

## **Neni 2**

### **Objekti i bashkëpunimit**

Palët bashkëpunojnë me njëra-tjetrën për krijimin dhe trajnimin e strukturës administrative për diasporën dhe migracionin në njësitë e qeverisjes vendore sipas parashikimeve të nenit 29/1 të ligjit Nr. 38/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

## **Neni 3**

### **Përgjegjësitë e palëve**

Bashkëpunimi sipas këtij memorandumi realizohet si vijon:

**Ministria e Brendshme** dhe strukturat përgjegjëse për migracionit në këtë institucion do të realizojnë:

1. Informimin e strukturave administrative për diasporën dhe migracionin në njësitë e qeverisjes vendore, mbi politikën shtetërore për migracionin dhe programet përkatëse të cilat do të zbatohen në nivel vendor;
2. informimin për pjesëmarrje përfaqësuesve të strukturave administrative për diasporën dhe migracionin të bashkive në takimet konsultuese dhe aktivitetet për çështjet e migracionit;
3. Bashkëpunimin me strukturat administrative për diasporën dhe migracionin të bashkive në lidhje me rishikimin e aktiviteteve të lidhura me çështjet e migracionit dhe në ofrimin e shërbimeve ndaj migrantëve;
4. Informimin e përfaqësuesve të strukturave administrative për diasporën dhe migracionin në bashki mbi asistencën e donatorëve, thirrjet për projekt - propozime, përfshirë programet lokale për parandalimin e migracionit të parregullt, nga të cilat përfitojnë njësitë e vetëqeverisjes vendore;
5. Bashkëpunimin dhe konsultimin me strukturat administrative për diasporën dhe migracionin të bashkive, për të hartuar dhe zbatuar programe të veçanta për të rinjtë dhe familjet e tyre me qëllim reduktimin e migracionit të parregullt.
6. Mbështetjen e strukturave administrative për diasporën dhe migracionin të bashkive me informacion për legjislacionin shqiptar në fuqi, në lidhje me statusin e shtetasve që duan të emigrojnë apo të kthehen, si dhe për të huajt që qëndrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.



**Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme** dhe strukturat përgjegjëse në këtë institucion realizojnë:

1. Koordinimin me trupin diplomatik për shkëmbimin e informacionit me strukturat administrative për diasporën në njësite e qeverisjes vendore për komunitetet shqiptare ndaj të cilave shprehin interes njësitë e qeverisjes vendore;
2. Asistimin për koordinimin e aktiviteteve për komunitetet shqiptare me origjinë nga territoret e njërive të qeverisjes vendore në vendin pritës;
3. Koordinimin me Ministrinë përgjegjëse për punët e brendshme, ministrin përgjegjës për diasporën për garantimin e dhënies së ndihmës e të informacionit për çështjet që lidhen me diasporën dhe migracionin.

**Ministri Shtetit për Diasporën** nëpërmjet Agjencisë Kombëtare për Diasporën realizon:

4. Sigurimin e pjesëmarrjes së përfaqësuesve të strukturave administrative për diasporën dhe migracionin të bashkive në forumet apo strukturat konsultuese referuar çështjeve të diasporës dhe çështjeve të lidhura me të;
5. Koordinimin e partneritetit ndërmjet institucioneve të qeverisjes vendore dhe organizatave/komuniteteve të diasporës në funksion të zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm vendor, edukimin e të rinjve dhe promovimin e vlerat historike dhe kulturore lokale;
6. Informimin e përfaqësuesit të strukturave administrative për diasporën dhe migracionin në bashki mbi asistencën e donatorëve, thirrjet për projekt - propozime, përfshirë programet nga të cilat përfitojnë njësitë e vetëqeverisjes vendore;
7. Nxitjen dhe ndihmën për informacionin e domosdoshëm, për të interesuarit nga komunitetet shqiptare në diasporë për legjislacionin shqiptar në fushën e investimeve.
8. Koordinimin me Agjencinë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, me qëllim trajnimin e personelit të strukturës administrative për diasporën dhe migracionin në çdo bashki;
9. Asistimin në përcaktimin e aktiviteteve vjetore dhe të prioriteteve dhe/ose çështjeve në trajtimin e çështjeve të diasporës dhe migracionit nga bashkitë e vendit.

**Shoqata për Autoniminë Vendore** bashkëpunon për realizimin si më poshtë të:

10. Vendimmarrjes dhe funksionimit të strukturës administrative për diasporën dhe migracionin në çdo bashki të vendit brenda vitit 2020.
11. Trajnimit të përbashkët të burimeve njerëzore të strukturës administrative për diasporën dhe migracionin në çdo bashki për zbatimin e politikës shtetërore të diasporës dhe migracionit.
12. Përgatitjes së kalendarit vjetor të aktiviteteve për diasporën dhe migracionin në çdo bashki të vendit dhe krijimin e platformave elektronike në çdo njësi të qeverisjes vendore të cilat do ti shërbejnë informimit mbi aktivitetet dhe çështjet e diasporës dhe migracionit.



#### **Neni 4**

### **Përgjegjësitë e strukturës administrative për diasporën dhe migracionin**

Përgjegjësitë dhe detyrat e strukturës administrative për diasporën dhe migracionin në bashki janë si më poshtë:

1. Nxitja e organizimeve, brenda dhe jashtë vendit, për mbajtjen e komunikimit të vazhdueshëm dhe forcimin e marrëdhënieve me diasporën dhe migrantët shqiptarë të cilët kanë vendlindjen ose origjinën nga territori që ato mbulojnë;
2. Informimin e të interesuarve nga diaspora dhe migracioni për legjislacionin shqiptar në fushën e investimeve në hapësirën e bashkive përkatëse.
3. Informojnë për çështjet që lidhen me fitimin e shtetësisë shqiptare;
4. Bashkërendojnë me strukturat administrative të bashkisë për rritjen e kapacitetit përthithës të projekteve të Bashkimit Evropian në dobi të komunitetit të diasporës dhe migrantëve;
5. Koordinojnë dhe bashkërendojnë punën me ministritë përgjegjëse për punët e brendshme, për punët e jashtme dhe për diasporën, për dhënien e informacionit për çështjet që lidhen me diasporën dhe migracionin;
6. Krijojnë platformat elektronike dhe shpërndajnë informacionin për çështjet e diasporës dhe migracionit, në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse të komunikimit digjital në bashki, e cila administron dhe publikon informacionin në faqen zyrtare të internetit të bashkisë.

#### **Neni 5**

### **Monitorimi**

Ministria e Brendshme, Ministri përgjegjës për Diasporën dhe Agjencia Kombëtare për Diasporën, monitorojnë në mënyrë periodike për përmbushjen e detyrimeve nga bashkitë, lidhur me ngritjen e strukturave administrative për diasporën dhe migracionin dhe performancën në zbatimin e funksioneve të tyre.

#### **Neni 6**

### **Komunikimi mes palëve**

1. Palët angazhohen të krijojnë një Sekretari Teknike të përbërë nga përfaqësues të Palëve.
2. Detyrat e Sekretarisë Teknike konsistojnë në realizimin e komunikimit dhe koordinimit të e veprimeve që duhet të ndërmerren rast pas rasti për realizimin e këtij Memorandumi.
3. Palët, angazhohen të mbajnë një komunikim të vazhdueshëm ndërmjet tyre dhe të shkëmbejnë çdo informacion të nevojshëm për përmbushjen e detyrave të tyre. Komunikimi do të kryhet në formë shkresore ose në rrugë elektronike. Në çdo rast të paraqitjes së një kërkesë, palët angazhohen të japin përgjigje brenda 10 ditëve.



#### **Neni 7**

#### **Kostot financiare**

Kostot financiare që rezultojnë nga zbatimi i këtij Memorandumi i nënshtrohen legjislacionit në fuqi dhe janë brenda kufijve të shpenzimeve buxhetore të parashikuara në buxhetin vendor të secilës bashki.

#### **Neni 8**

#### **Ndryshimi i Memorandumit**

Ky memorandum mund të ndryshojë vetëm me marrëveshje të palëve nëpërmjet shkëmbimit të komunikimit me shkrim.

#### **Neni 9**

#### **Kohëzgjatja e Memorandumit**

Ky memorandum nënshkruhet për një afat kohor të pacaktuar.

#### **Neni 10**

#### **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin ose zbatimin e këtij memorandumi zgjidhet me mirëkuptim mes palëve.

#### **Neni 10**

#### **Hyrja ne Fuqi**

Memorandumi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij dhe publikohet në faqet zyrtare të Palëve. Memorandumi përgatitet dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje origjinale, një prej të cilave depozitohen pranë Ministrit të Shtetit për Diasporën, një pranë Ministrisë së Brendshme, një pranë Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, dhe një pranë Shoqatës për Autonominë Vendore dhe një pranë Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë. Nënshkruar në Tiranë, në \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020.

**MINISTRI I BRENDSHËM  
SANDËR LLESHAJ**

**MINISTRI NË DETYRË PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME  
GENT CAKAJ**

**MINISTRI I SHTETIT PËR DIASPORËN  
PANDELI MAJKO**

**KRYETARI I SHOQATËS PËR AUTONOMINË VENDORE  
ERJON VELIAJ**